



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.66

28 maj

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7002 datë 10.5.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	2659
Dekret nr.7003 datë 10.5.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	2659
Akt normativ nr.2, datë 29.4.2011	Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët detare-amfibe “Albanian Lion, 2011”	2660
Vendim i KM nr.322, datë 29.4.2011	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për 4 bashki dhe 13 komuna.....	2661
Vendim i KM nr.323, datë 29.4.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e shpenzimeve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, më 8 maj 2011	2662
Vendim i KM nr.324, datë 29.4.2011	Për kalimin e objekteve të ish-qytetit të nxënësve, pranë shkollës së mesme teknologjike, Tiranë, në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi	2663
Vendim i KM nr.325, datë 29.4.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.31, datë 19.1.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në vendimin nr.332, datë 17.3.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e formës, elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga Shërbimi i Gjendjes Civile”.....	2666

Vendim i KM nr.326, datë 29.4.2011	Për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Brendshme ...	2666
Vendim i KM nr.329, datë 17.5.2011	Për rishpërndarje fondesh, brenda programeve, në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit dhe për përdorimin e tyre për pagesën e detyrimeve të energjisë elektrike të shoqërive të ujësjellësve...	2667
Udhëzim i MMPAU nr.2, datë 26.4.2011	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.4, datë 25.8.2010 të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e grupngastrave për shfrytëzim, rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”	2669
Vendim i GJK nr.17, datë 16.5.2011	Me objekt shfuqizimin e vendimeve: nr.21, datë 16.1.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.728, datë 2.7.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshme me Kushtetutën	2671
Vendim i BSH nr.29, datë 27.4.2011	Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi minimumin e rezervës së detyruar të mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”	2676
Vendim i BSH nr.33, datë 11.5.2011	Për një shtesë në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”	2677
Urdhër i BSH nr.3652, datë 29.4.2011	Për miratimin e shtesës së një veprimtarie financiare në licencën e subjektit financiar jobankë AK-INVEST sh.a.....	2678
Vendim i KKRT nr.142, datë 29.4.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv A1”	2678
Vendim i KKRT nr.143, datë 29.4.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Lezha”	2679
Vendim i KKRT nr.144, datë 29.4.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio e Parë Mat”	2679
Vendim i KKRT nr.145, datë 29.4.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv 6+1”	2680
Vendim i ERE nr.45, datë 10.5.2011	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., me seri PV05V, nr.29, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.116, datë 28.12.2010	2680
Kërkesë e MPPT nr.1389/3, datë 6.5.2011	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private (objekte dhe pemë dekorative), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor rruga paralele Tiranë-Vorë (krahu i majtë).....	2681

Vendim për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar, shtetasit Sami Çela dhe caktimin si kujdestar ligjor të tij shtetasin Fatos Çela	2682
Vendim për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar, shtetasit Gëzim Goci dhe caktimin si kujdestar ligjor të tij shtetasin Zenel Goci.....	2682
Vendim për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar, shtetasve Blerim Zylfa dhe Kastriot Zylfa dhe caktimin si kujdestare ligjore të tyre shtetasen Mirjeta Zylfa	2682
Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasve: Geg Matrizi, Vitore Deda, Flora Matrizi	2683
Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Arben Allko dhe caktimin si kujdestare të pasurisë së tij shtetasen Adelina Allko.....	2683

DEKRET
Nr.7002, datë 10.5.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 pika 7, nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:
Mustafa Eyüp Yaşar Kuşata

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.7003, datë 10.5.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Anwar Fouad Rizik
2. Arbnesha Iljaz Lika (Telqiu)
3. Betül Abdullah Başhan
4. Birol Süleyman Inaltekin
5. Hysni Januz Kryeziu
6. Lirim Shukri Bajrami
7. Mentor Abedin Idrizi
8. Mentor Idriz Rama
9. MHD ABDA MHD Hosameddin Almezlom
10. MHD Hosameddin Bader eddin Almezlom
11. Mustafa Kamil Ertekin
12. Oktay Sadreddin Kantarkiran
13. Raghad MHD Hosameddin Almezlom
14. Raida Khalil Mardeni
15. Şuayip Hasan Hüseyin Başhan
16. Tarek M.Jomaa Arnaout

17. Tarek Mohammed Bech
18. Valdete Ruzhdi Bokshi (Veseli)
19. Yazan MHD Hosameddin Almezlom
20. Zeliha Şuayip Başhan

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

AKT NORMATIV
Nr.2, datë 29.4.2011

**PËR ZHVILLIMIN DHE PJESËMARRJEN E FORCAVE USHTARAKE TË BRITANISË SË
MADHE NË STËRVITJEN E PËRBASHKËT DETARE-AMFIBE “ALBANIAN LION, 2011”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët detare-amfibe “Albanian Lion, 2011” në kuadër të bashkëpunimit dypalësh.

Neni 2

Lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 3500 trupave ushtarake të Britanisë së Madhe.

Neni 3

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është realizimi i operacioneve joluftarake të evakuimit (NEO-Non-Combatant Evacuation Operations) nëpërmjet detit dhe ajrit, duke përfshirë anije, helikopterë dhe mjete transporti.

Neni 4

Stërvitja zhvillohet në periudhën 27 maj - 3 qershor 2011, në rajonin e gjirit të Vlorës, në gadishullin e Karaburunit, ishullin e Sazanit, bazën e Porto-Palermos, bazën e Kuçovës.

Neni 5

Në këtë stërvitje angazhohen 3500 trupa, 10 anije luftarake, 1 nëndetëse bërthamore, 25 helikopterë sulmues dhe transporti dhe 100 mjete transporti të Forcave të Armatosura Mbretërore Britanike, të cilat do të kryejnë lëvizje gjatë 24 orëve në rajonin e përcaktuar të stërvitjes, sipas nenit 4 të këtij akti normativ. Në rajonin e Karaburunit do të kryejnë veprimtari 400 marinsa të Forcave të Armatosura Mbretërore Britanike, të cilët do të stimulojnë stërvitjen nga deti në tokë.

Neni 6

Trupat britanike gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë do të kenë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951 dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.10 101, datë 26.3.2009.

Neni 7

Gjatë hyrjes, lëvizjes e daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, trupat dhe mjetet ushtarake britanike do të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 9

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.322, datë 29.4.2011

**PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR
PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 4 BASHKI
DHE 13 KOMUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 4 (katër) bashki dhe 13 (trembëdhjetë) komuna, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondi, në vlerën 50 870 254 (pesëdhjetë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) lekë, të përballohet nga Fondi i Kontigjencës.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Nr.	Emri i NJQV-së	Vlera (lekë)
1	Bashkia Konsipol (Sarandë)	1,688,000
2	Bashkia Libohovë (Gjirokastrë)	44,000
3	Bashkia Sarandë	30,359,202
4	Bashkia Tepelenë	4,486,227
5	Komuna Bubullimë (Lushnjë)	1,562,250
6	Komuna Cepo (Gjirokastrë)	660,000
7	Komuna Dhivër (Sarandë)	484,000
8	Komuna Fratar (Mallakastër)	1,410,000
9	Komuna Gradisht (Lushnjë)	1,932,575
10	Komuna Hysgjokaj (Lushnjë)	352,000
11	Komuna Kastriot (Dibër)	44,000
12	Komuna Lukovë (Sarandë)	2,318,000
13	Komuna Portez (Fier)	3,520,000
14	Komuna Q.Tomin (Dibër)	396,000
15	Komuna Qendër Libohovë (Gjirokastrë)	88,000
16	Komuna Topojë (Fier)	1,438,000
17	Komuna Ulëz (Mat)	88,000
	Shuma	50 870 254

VENDIM
Nr.323, datë 29.4.2011

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, MË 8 MAJ 2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, që do të zhvillohen më 8 maj 2011, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, t’i jepet një fond shtesë prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, të ndarë, si më poshtë vijon:

- a) 11 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) lekë për investime;
- b) 54 000 000 (pesëdhjetë e katër milionë) lekë për mallra e shërbime.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të vitit 2011.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.324, datë 29.4.2011

**PËR KALIMIN E OBJEKTEVE TË ISH-QYTETIT TË NXËNËSVE, PRANË SHKOLLËS
SË MESME TEKNOLOGJIKE, TIRANË, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, ME QËLLIM PRIVATIZIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore” dhe të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin e objekteve të mbetura të paprivatizuara, të ish-qytetit të nxënësve, pranë shkollës së Mesme Teknologjike, Tiranë, (ish-shkolla e Muzikës, ish-Shkolla e Mjeshtërisë së Futbollit), nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, sipas formularit dhe planimetrive bashkëlidhur, me qëllim privatizimi, në favor të banorëve të pastrehë, të cilët banojnë në këto godina dhe që nuk kanë bërë privatizimin.


2. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet ky ent të lidhë kontratat e privatizimit me banorët e pastrehë, sipas listave që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe kushteve të parashikuara në udhëzimin nr.22, datë 12.10.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit (Enti Kombëtar i Banesave) dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha





VENDIM
Nr.325, datë 29.4.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.31, DATË 19.1.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.332, DATË 17.3.2010 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS, ELEMENTEVE
PËRBËRËSE, MËNYRËS SË MBAJTJES E AFATIT TË PËRDORIMIT TË
DOKUMENTEVE BAZË, QË MBAHEN DHE LËSHOHEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES
CIVILE””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 25 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në paragrafin e fundit të vendimit nr.31, datë 19.1.2011 të Këshillit të Ministrave fjalët “... nga data 1.5.2011...” zëvendësohen me “... nga data 23.5.2011...”.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.326, datë 29.4.2011

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT
TË VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve, në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Brendshme, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Policia e Shtetit” të shtohet fondi 46 000 000 (dyzet e gjashtë milionë) lekë për plotësimin pjesor të financimit të projektit “Sistemi i vëzhgimit me kamera për qytetin e Tiranës”.

b) Në programin “Planifikim menaxhimi dhe administrim” të pakësohet fondi 46 000 000 (dyzet e gjashtë milionë) lekë, në zërin “Investime për rikonstruksionin e godinës së ministrisë”.

2. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.329, datë 17.5.2011

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, BRENDA PROGRAMEVE, NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT DHE PËR PËRDORIMIN E TYRE PËR PAGESËN E DETYRIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËSVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 17 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit të bëhet rishpërndarja e fondeve, brenda programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Ujësjellës-kanalizime”, shpenzime korente, të shtohet fondi prej 36 000 000 (tridhjetë e gjashtë milionë) lekësh, për pagesën e detyrimeve të energjisë elektrike të shoqërive të ujësjellësve, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në programin “Transporti hekurudhor”, shpenzime korente, të pakësohet fondi prej 36 000 000 (tridhjetë e gjashtë milionë) lekësh.

2. Ndërmarrjet e ujësjellësve, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, të paguajnë detyrimet e energjisë elektrike, në masën 573 000 000 (pesëqind e shtatëdhjetë e tre milionë) lekë, të cilat të përballohen nga fondi i papërdorur në programin “Ujësjellës-kanalizime”, zëri “Subvencione”.

3. Ndërmarrjet e ujësjellësve, në varësi të pushtetit vendor apo vetë njësitë e pushtetit vendor, në zbatim të ligjit nr.10 340, datë 28.10.2010 “Për pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve të ndërmarrjeve dhe sh.a.-ve, në pronësi të pushtetit vendor”, të jenë përgjegjëse për çdo detyrim tjetër që do të krijohet gjatë vitit 2011.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DETAJIMI I FONDIT TË SUBVENCIONIT PËR VITIN 2011 (ENERGJI ELEKTRIKE)

Muaji	Entiteti i qeverisjes	Ministria e linjës	Kodi i institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i degës së thesarit	Shuma e akorduar në lekë	Emri i institucionit përfitues
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
05-2011	033	06	2033019	01	06370	603	3333	8.034.078	Ndërm.ujësjellsi Vau i Dejës
05-2011	109	06	2109015	01	06370	603	0808	60.612.648	Sh.a.Ujësjellësi Elbasan qytet (Elber)
05-2011	033	06	2033036	01	06370	603	3333	13.695.307	Sh.a. Ujësjellësi Shkodër fshat
05-2011	109	06	2109016	01	06370	603	0808	30.794.088	Sh.a. Ujësjellësi Elbasan fshat
05-2011	133	06	2133005	01	06370	603	2026	7.317.386	Sh.a.Ujësjellësi Mirditë
05-2011	119	06	2119004	01	06370	603	3513	3.764.539	Sh.a. Ujësjellësi Rrogozhinë
05-2011	022	06	2022003	01	06370	603	0922	19.445.259	Sh.a. Ujësjellësi Lushnjë qytet
05-2011	126	06	2126007	01	06370	603	2019	36.216.165	Sh.a. Ujësjellësi Kurbini
05-2011	111	06	2111019	01	06370	603	0909	99.488.139	Sh.a. Ujësjellësi Fier
05-2011	138	06	213008	01	06370	603	3731	22.542.625	Sh.a. Ujësjellësi Sarandë
05-2011	141	06	2141032	01	06370	603	3333	49.255.909	Sh.a. Ujësjellësi Shkodër qytet
05-2011	146	06	2146029	01	06370	603	3737	44.947.638	Sh.a. Ujësjellësi Vlorë
05-2011	163	06	2163002	01	06370	603	0716	15.856.339	Sh.a. Ujësjellësi Fushë-Krujë
05-2011	112	06	2112006	01	06370	603	0909	82.912.716	Sh.a. Ujësjellësi Patos
05-2011	145	06	2145010	01	06370	603	1836	9.522.827	Sh.a. Ujësjellësi Tropojë
05-2011	137	06	2137021	01	06370	603	3330	394.733	Sh.a. Ujësjellësi Pukë fshat
05-2011	127	06	2127009	01	06370	603	2020	53.248.131	Sh.a. Ujësjellësi Lezhë
05-2011	166	06	2166003	01	06370	603	3535	7.127.513	Ndërmarrja e Ujësjellsit Kamëz
05-2011	104	06	2104004	01	06370	603	3704	7.132.839	Sh.a. Ujësjellësi Delvinë
Totali								572.308.879	Totali

UDHËZIM
Nr.2, datë 26.4.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 25.8.2010 TË MINISTRISË SË
MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE “PËR KËRKESAT TEKNIKE
TË CAKTIMIT TË NGASTRAVE E GRUPNGASTRAVE PËR SHFRYTËZIM,
RREGULLAT PËR VJELJEN E MATERIALIT DRUSOR DHE SHITJEN ME ANKAND TË
LËNDËS DRUSORE E TË PRODHIMEVE TË TJERA PYJORE E JOPYJORE”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 27 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, të pikës IV/8 dhe të pikës 1/10 të vendimit nr.394, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr.4, datë 25.8.2010 të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 9, kreu XI, ndryshohet si më poshtë vijon:

“9. Ankandi bëhet i hapur për çdo parti asortimentesh ose për të gjitha partitë e të njëjtit asortiment që i përkasin së njëjtës cilësi dhe të njëjtit lloj drusor, si dhe për çdo njësi mbarështimi (n/ngastër, ngastër të bashkuara në lote), grupngastra, pjesë ekonomike, ekonomi pyjore, me dhe pa rrugë autopsyjore, si edhe për prodhimet e dyta pyjore”.

2. Pika 10, kreu XI, ndryshohet si më poshtë vijon:

“10. Shitja e lëndës drusore në këmbë me ankand do të bëhet me procedurë të hapur për çdo njësi mbarështimi (n/ngastër, ngastër, të bashkuara në lote), grupngastra, pjesë ekonomike, ekonomi pyjore në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, rregullave të vendimit nr.1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, dokumenteve standarde të ankandit publik, të hartuara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) dhe udhëzimit nr.4, datë 25.8.2010 të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.”.

3. Titulli i kreut XII, ndryshohet si më poshtë vijon:

“XII. Kërkesat lidhur me pjesëmarrjen në ankand të shfrytëzimit të ngastrave e grupngastrave me dhe pa rrugë autopsyjore.”.

4. Pika 2, kreu XII, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Për shfrytëzimin e ngastrave me rrugë autopsyjore, si dhe për trajtimin e shfrytëzimin e ngastrave/grupngastrave pa rrugë auto e ndërtimin e rrugëve autopsyjore në to, kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm personat juridikë, të cilët plotësojnë këto kriteret:

a) të kenë zhvilluar aktivitet për trajtimin dhe shfrytëzimin e pyjeve, jo më pak se 5 vjet të dokumentuar, të vërtetuara me kontrata nga drejtoritë e shërbimit pyjor, shoqëruar me vërtetime për realizimin me sukses të tyre. Në rastin e bashkimit të operatorëve ky kriter duhet të plotësohet nga subjekti kryesues i grupit;

b) të kenë në pronësi kapacitete teknike specifike për punime pyjore e me impakte të ulëta mjedisore, mjete transporti dhe financiare për të shfrytëzuar jo më pak se 2500 m³ lëndë drusore në vit ose aq sa është mundësia vjetore e shfrytëzimit me prerje të lejuara për ato grupngastra, të vërtetuara këto me bilance vjetore pozitive dy vitet e fundit, shoqëruar me inventarin e aktiveve, fatura blerje, leje qarkullimi ose të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

c) të kenë në pronësi makineri e pajisje, si: kamionë, fadroma me zinxhirë e goma për ndërtimin e rrugëve autopsyjore, të vërtetuar këto me bilance vjetore shoqëruar me inventarin e aktiveve, fatura blerje, leje qarkullimi ose të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

d) të kenë fuqi punëtore të siguruar me kontratë për 6-mujorin e fundit nga secili operator ose kryesuesi i grupit të vërtetuar me deklaram në zyrën e punës dhe nga drejtoria rajonale e tatimeve:

- për operatorët me aktivitetet në pyjet e lartë në ngastrat me rrugë autopsyjore dhe pa rrugë autopsyjore, jo më pak se 20 punonjës;

- për operatorët me aktivitetet në pyjet e ulëta dhe shkurret, jo më pak se 8 punonjës;

e) të kenë punëtorë të certifikuar për përdorimin e mjeteve prerëse në pyje dhe pajisje e veshje speciale për sigurimin në punë të jetës së punonjësve;

f) të kenë xhiro vjetore jo më pak se 25 milionë lekë për 2 vitet e fundit për operatorët me aktivitetet në pyjet e larta dhe mbi 5 milionë lekë për operatorët me aktivitetet në pyjet e ulëta dhe shkurret, të vërtetuar nga tatim-taksat.

Përparësi në ankand të kenë subjektet shfrytëzuese dhe përpunuese të lëndës drusore, kjo e vërtetuar me faturat e shitjes tatimore dhe doganore.

g) çdo subjekt veças apo i bashkuar të mos jetë debitor ndaj institucioneve shtetërore e private, kjo e vërtetuar nga tatim-taksat.

i) të mos kenë kryer vepër penale apo kundërvajtje administrative në fondin pyjor e kullor kombëtar.”.

5. Pika 3, kreu XII, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Personat juridikë, të interesuar për pjesëmarrje në ankand për ngastrat, grupngastrat pa rrugë autopsyjore, duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë edhe këto dokumente:

a) kërkesën me shkrim me gjeneralitetet e kërkesës, si dhe objektin e kërkesës, përcaktimin e ngastrave e grupngastrave pyjore që janë të palidhura me rrugë autopsyjore dhe për të cilat shprehet interes për ndërtimin e rrugës me shpenzimet e veta, për trajtimin e shfrytëzimin e tyre;

b) studimin tekniko-ekonomik dhe programin përkatës të investimeve dhe shfrytëzimeve të hartuara nga specialistë të licencuar, i cili duhet të respektojë masat e trajtimit, të përcaktuara sipas planit të mbarështimit a inventarizimit në studimin përkatës, sipas azhurnimit të kryer vitin e fundit;

c) projektin dhe preventivin e ndërtimit të rrugës autopsyjore me të gjitha elementet përbërëse në tri kopje, të hartuar nga specialistë të licencuar;

d) projektet teknologjike të trajtimit e të shfrytëzimit të ngastrave, grupngastrave pyjore, për vitin e parë të prerjes;

e) vërtetim, që provon se organet e qeverisjes vendore dhe komuniteti përreth janë dakord me zbatimin e projektit të rrugës së kërkuar, kur rruga autopsyjore kalon në territorin e njësisë së qeverisjes vendore;

f) formularin e sigurimit të ofertës, në masën 2% të vlerës së vëllimit të materialit drusor, që do të shfrytëzohet në fazën e parë të prerjeve, për grupimet e ngastrave pa rrugë autopsyjore, të lëshuar vetëm nga bankat;

g) lejen e mjedisit nga secili operator.”.

6. Pas pikës 22 shtohet pika 22/1 me këtë përmbajtje:

“22./1 Të njëjtat procedura për trajtimin dhe shfrytëzimin e pyjeve do të zbatohen edhe për pyjet transferuar komunitetit.”.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, drejtoritë e shërbimit pyjor në rrethe dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

VENDIM
Nr.17, datë 16.5.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 15.2.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.47/32 akti që i përket:

KËRKUES: Marjan Stojani, përfaqësuar nga avokati Skënder Demiraj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve: nr.21, datë 16.1.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.728, datë 2.7.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha, përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi është deklaruar fajtor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin me vendimin nr.60, datë 29.4.2008 për veprën penale “të armëmbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal (KP) dhe është dënuar me 2 (dy) vjet burgim.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.21, datë 16.1.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të dënimit.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, me vendimin nr.728, datë 2.7.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë edhe një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal nr.60, datë 29.4.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, kërkesë e cila është pranuar me urdhrin nr.19, datë 31.3.2009 të Kryetares së Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në datën 20.9.2010 duke pretenduar shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), pasi ato i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtimet e mëposhtme:

- *Është cenuar e drejta e mbrojtjes.* Gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë kërkuesi është gjykuar në mungesë, si rezultat i mosrespektimit të dispozitave procedurale penale për njoftimin e të pandehurit, në gjendje të lirë. Ndonëse ai është përfaqësuar nga mbrojtësi i tij, ky i fundit nuk ka qenë i autorizuar me prokurë për ta përfaqësuar në mungesë në Gjykatën e Apelit.

- *Është cenuar e drejta e ushtrimit efektiv të ankimit* për shkak të moskalimit të rekursit për shqyrtim në seancë plenare, ndonëse përmbante shkaqe të plota dhe të bazuara në ligjin material dhe procedural. Kolegji Penal, në Dhomën e Këshillimit, nuk ka atributin të shqyrtojë shkeljet e pretenduara, pasi këto merren në shqyrtim gjatë procesit gjyqësor, në prani të palëve.

- *Nuk është respektuar standardi kushtetues për arsyetimin e vendimit nga gjykata.* Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk argumentojnë shkaqet dhe arsyet që kanë çuar përkatësisht në fajësinë e kërkuesit dhe në mospranimin e rekursit.

Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, në parashtimet e paraqitura me shkrim, prapësoi si vijon:

- Është i pabazuar pretendimi i kërkuesit se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka marrëtribute të seancës gjyqësore dhe se vendimi i mospranimit të rekursit ka cenuar elemente të procesit të rregullt ligjor. Mosarsyetimi nga Kolegji Penal i shkaqeve të mospranimit të rekursit përbën tashmë një praktikë të konsoliduar që nuk cenon standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

- Në kundërshtim me sa pretendon kërkuesi për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur, së drejtës për t'u dëgjuar dhe të drejtës së ankimit, në kuptim të neneve 42 e 43 të Kushtetutës, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, nuk ka cenuar asnjë prej elementeve të procesit të rregullt ligjor dhe ka vepruar në përputhje me Kushtetutën dhe Kodin e Procedurës Penale (KPP).

- Kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion për pretendimet se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Apelit është i parregullt, pasi nuk janë respektuar kërkesat ligjore për njoftimin e të pandehurit në gjendje të lirë, për përfaqësimin ligjor, ndërkohë që kërkuesi ishte në mungesë, ose dhe për mosekzistencën e veprës penale.

II

1. Në lidhje me pretendimin për cenimin e të drejtës së mbrojtjes

Kërkuesi ka pretenduar se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë atij i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Gjykata konstaton se nga përmbajtja e dokumenteve të administruara në dosjen gjyqësore, pretendimet e mësipërme nuk janë ngritur nga kërkuesi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, duke mos respektuar kështu standardin kushtetues të shterimit të mjeteve juridike përpara paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, sanksionuar nga neni 131, shkronja "f" e Kushtetutës.

Gjykata rithekson se rregulli i vendosur nga dispozita e mësipërme kushtetuese e detyron kërkuesin që, për zgjidhjen e çështjes së tij, t'iu drejtohet të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.1, datë 25.1.2010*).

Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka shfrytëzuar mjetet efektive, për të realizuar ndreqjen e shkeljes së të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor dhe, për rrjedhojë, ai nuk legjitimohet të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues.

2. Në lidhje me pretendimin për cenimin e ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit në Gjykatën e Lartë

Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit në Dhomën e Këshillimit, ka cenuar të drejtën e ankimit, sepse ky Kolegji nuk ka atributin të shqyrtojë shkeljet e pretenduara, pasi ato merren në shqyrtim gjatë procesit gjyqësor, në prani të palëve.

Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme, Gjykata ka vlerësuar se është kompetencë e Kolegjit të Gjykatës së Lartë të analizojë dhe të vlerësojë në Dhomë Këshillimi nëse shkaqet e

ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se ky Kolegj, në Dhomën e Këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr.19, datë 19.7.2005; nr.4, datë 25.2.2009; nr.18, datë 8.7.2009; nr.1, datë 25.1.2010*).

Në rastin konkret, Gjykata konstaton se, nga pikëpamja kushtetuese, vendimi i Kolegjit Penal për mospranimin e rekursit, të paraqitur nga i pandehuri, nuk vë në dyshim të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson si haptazi të pabazuara pretendimet e kërkuarit për cenimin e të drejtës së ankimit si rezultat i mosprimit të rekursit nga Kolegji Penal, në Dhomë Këshillimi.

3. Në lidhje me pretendimin për mosarsyetimin e vendimeve gjyqësore

Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se vendimet e dhëna nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, kanë cenuar standardin kushtetues të arsytimit të vendimeve, parashikuar nga neni 142/1 i Kushtetutës. Sipas tij, Gjykata e Apelit nuk ka pasqyruar me saktësi dhe vërtetësi faktet dhe rrethanat e çështjes dhe ka arritur në përfundime të gabuara, pa u bazuar në provat e administruara gjatë gjykimit të çështjes, kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar shkaqet e mosprimit të rekursit.

Gjykata rikonfirmon qëndrimin se arsytimi i vendimeve gjyqësore është një element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se e drejta që i garantohet një ndërgjyqësi prej nenit 6 të KEDNJ-së përfshin edhe arsytimin e vendimeve të marra nga një gjykatë vendase për çështjen e tij. Sidoqoftë, detyrimi që ka gjykata vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsytim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsytimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë. Veçanërisht gjatë gjykimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, kur kjo e fundit nuk pranon një rekurs, për shkak se nuk është parashtruar baza ligjore e çështjes, kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së mund të plotësohen me një arsytim shumë të kufizuar (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet “Marini kundër Shqipërisë”, datë 18.12.2007, §105-106; “Mishgjoni kundër Shqipërisë”, datë 7.12.2010, § 51*).

Elementet që duhet të përmbajë një vendim penal përcaktohen shprehimisht nga KPP-ja, që parashikon, gjithashtu, se nëse vendimi nuk arsyetohet, ai është i pavlefshëm. Konkretisht, neni 383 i KPP-së përcakton, ndër të tjera, detyrimin e gjykatës për të pasqyruar në vendim parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, si dhe dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit. Vendimi gjyqësor duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 2.4.2008 dhe nr.8, datë 16.3.2011*).

Në çdo rast, vendimi gjyqësor duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Përfundimet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 9.3.2009; nr.23, datë 23.7.2009; nr.38, datë 30.12.2010; nr.8, datë 16.3.2011*).

Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.21, datë 16.1.2009, duke u mbështetur në përshkrimin e rrethanave të çështjes, në analizën e provave dhe logjikën e fakteve të marra në unitet, ka arritur në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Kurbin, për sa i përket fajësisë dhe masës së dënimit, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe prova dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi. Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë pasqyron tërësinë e fakteve/ngjarjeve ashtu siç janë administruar në gjykim, si dhe mënyrën mbi bazën e të cilës janë analizuar dhe vlerësuar provat që kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe në rrethanat e çështjes, Gjykata vlerëson se argumentet e Gjykatës së Apelit Tiranë janë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese të vendimit të kësaj gjykate dhe nuk cenojnë ndonjë prej elementet e arsytimit të vendimit gjyqësor. Në vlerësimin e Gjykatës nuk rezulton që vendimi i kundërshtuar të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky vendim nuk cenon kërkesat që lidhen me arsytimin e vendimit gjyqësor dhe pretendimi i kërkuarit në këtë aspekt është i pabazuar.

Për sa i përket pretendimit të kërkuarit se edhe vendimi nr.728, datë 2.7.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar shkaqet e mospranimit të rekursit, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar. Kjo formë arsytimi e vendimit të mospranimit të rekursit shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e Kolegjit Penal gjatë shqyrtimit të tij paraprak në Dhomën e Këshillimit dhe nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila mund të ndikojë negativisht në drejtim të garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të kërkuarit.

Përfundimisht, Gjykata arrin në përfundimin se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë, kërkuarit Marjan Stojani nuk i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Altina Xhoxhaj.

Anëtarë kundër: Admir Thanza, Vitore Tusha.

MENDIM PAKICE

Jemi kundër vendimit të shumicës në lidhje me qëndrimin që ka mbajtur për pretendimin e kërkuarit për mosarsyetimin e vendimit nr.21, datë 16.1.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr.728, datë 2.7.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

Kërkuari ka parashtruar në kërkesën e tij se në proceset gjyqësore penale, të zhvilluara në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor për shkak të mosarsyetimit të vendimeve sipas kërkesave ligjore, pretendim të cilin e ka ngritur dhe në rekursin e ushtruar prej tij në Gjykatën e Lartë.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata), në jurisprudencën e saj të vazhdueshme, ka theksuar se kontrolli kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore, është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.31, datë 1.12.2005 dhe nr.22, datë 22.7.2009*).

Gjykata ka theksuar se domosdoshmëria e arsytimit të vendimeve gjyqësore përbën një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, në analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe në funksion të njëra-tjetrës. Kërkesat për standardin e arsytimit të vendimit penal, janë sanksionuar në nenin 383 Kodit të Procedurës Penale (KPP), në të cilin përcaktohet se elementet që duhet të përmbajë një vendim, janë: një parashtrim i përmbledhur i rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, si dhe dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit dhe se vendimi duhet të arsyetohet, ndryshe është i pavlefshëm (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 2.4.2008*).

Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë jo vetëm i rregullt në formë, por i qartë në përmbajtje dhe logjik. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Përfundimet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 9.3.2009; nr.23, datë 23.7.2009; nr.38, datë 30.12.2010; nr.8, datë 16.3.2011*).

Shumica, megjithëse i referohet jurisprudencës së mësipërme të kësaj Gjykate, bën vlerësim të gabuar kur arsyeton se standardet e arsytimit janë respektuar në proceset gjyqësore. Në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, që është objekt i këtij gjykimi, nuk rezulton të jetë bërë analizë e provave, mbi bazën e të cilave ajo Gjykatë të ketë krijuar bindjen për fajësinë e kërkuesit, por vetëm në një paragraf shprehet se “*Në këto rrethana e ndodhur çështja, nga analiza e provave dhe logjika e fakteve të marra në unitet, Gjykata e Apelit konstaton se vendimi i Gjykatës së Faktit është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe prova dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi, për sa i përket fajësisë dhe masës së dënimit.*” Gjithashtu, Gjykata e Apelit e ka marrë të mirëqenë arsyetimin dhe analizën e provave të bëra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin në vendimin nr.60, datë 29.4.2008, vendim i cili ka deklaruar fajësinë e kërkuesit, duke u bazuar, midis të tjerash, në: i) *prova të marra “me rezervë”*, si rezultat i kundërshtive midis deklarimeve në seancë të dëshmitarit kryesor okular KS (vëllai i të pandehurit) dhe atyre të deklaruara në procesverbalin e marrjes së të dhënave nga persona që kanë dijeni për veprën penale (f.31/2 e fashikullit hetimor, f.27/2 dhe 30 të procesverbalit të seancës dëgjimore) dhe i cilëson ato “si të dyshimta, jo korrekte dhe konfuze” (f.3 e vendimit). Me rezervë janë vlerësuar edhe deklaratimet e të dëmtuarit AK, i cili, sipas arsytimit të gjykatës “nuk mund të përgjegjësojë veten për mbajtjen e armës, por të pandehurin M. Stojani”; ii) *konkluzione kontradiktore, si: “Dëshmi të tjera të administruara në gjykim nuk zbardhën të vërtetën se kujt i përkiste arma e zjarrit, por që provuan se arma ishte mbajtur në dorë nga i pandehuri pas grindjes”* ose “... edhe sikur të pranojmë se kjo armë i ishte marrë dëshmitarit AK (i dëmtuari) nga i pandehuri Marjan Stojani, përsëri ky shtetas e ka konsumuar veprën penale të mbajtjes pa leje të armës luftarake” (f.4 e vendimit); iii) *arsyetimin e pjesshëm të shkaqeve të pushimit të procedimeve penale të mëparshme ndaj palëve*, duke u ndalur vetëm në përshkrimin e shkaqeve të pushimit të ndjekjes penale ndaj të pandehurit M.Stojani akuzuar për veprën penale “plagosje e lehtë” dhe duke mospërmendur shkaqet e pushimit të ndjekjes penale ndaj të dëmtuarit AK për veprën penale “armëmbajtje pa leje”.

Është e vërtetë që vlerësimi i provave nuk përbën atribut të juridiksionit kushtetues, por të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, të cilat çmojnë provat, duke përcaktuar vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, ku çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. Nga ana tjetër, ekzistenca e faktit nuk mund të nxirret nga indiciet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën (neni 152 i KPP-së).

Megjithatë, nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili i referohet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, rezulton se argumentet e pjesës arsyetuese, të mbështetura në provat e administruara gjatë procesit gjyqësor, nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, për shkak të kundërthënieve të hapura dhe, si të tilla, këto argumente nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese, pikërisht *“lënien në fuqi të vendimit për sa i përket fajësisë dhe masës së dënimit”*.

Nuk jemi dakord, gjithashtu, me arsyetimin e shumicës për pabazueshmërinë e pretendimit të kërkuarit për mosarsyetimin e vendimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi.

Është kompetencë e Kolegjit të Gjykatës së Lartë të analizojë dhe të vlerësojë në Dhomë Këshillimi nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se ky Kolegj, në Dhomën e Këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në të kundërt, kur shkaqet e ngritura në rekurs janë të tilla që evidentojnë cenimin e ndonjë prej elementeve të procesit të rregullt ligjor, siç është dhe arsyetimi i vendimit, vlerësimi mbi mënyrën e zbatimit të ligjit procedural nga Kolegji i Gjykatës së Lartë përfshihet në juridiksionin kushtetues.

Nga sa më sipër, në rrethanat kur standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor është cenuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe nuk është riparuar nga Gjykata e Apelit dhe ky pretendim është parashtruar në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë, vlerësojmë se nga pikëpamja kushtetuese, vendimi i Kolegjit Penal, në Dhomë Këshillimi, për mospranimin e rekursit të kërkuarit, vë në dyshim respektimin e të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor.

Përfundimisht, në ndryshim nga sa argumenton shumica, mendojmë se në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë nuk është respektuar një nga standardet e procesit të rregullt ligjor lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së dhe, për rrjedhojë, është cenuar e drejta e kërkuarit për një proces të rregullt ligjor.

Anëtarë: Vitore Tusha, Admir Thanza.

VENDIM **Nr.29, datë 27.4.2011**

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “MBI MINIMUMIN E REZERVËS SË DETYRUAR TË MBAJTUR NË BANKËN E SHQIPËRISË NGA BANKAT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43 shkronja “c” të nenit 19 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të nenit 67 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi minimumin e rezervës së detyruar të mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat” miratuar me vendimin nr.43, datë 16.7.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 12, përmbajtja e pikave “1” dhe “4” ndryshon përkatësisht si më poshtë:

“1. Banka e Shqipërisë mund të remunerojë bankat për mbajtjen e rezervës së detyruar në lekë dhe në valutë, për periudhën e mbajtjes së saj.”

“4. Në rast të remunerimit, përkatësisht të rezervës së detyruar në lekë dhe në valutë, normat e remunerimit përcaktohen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe njoftohen të paktën 30 (tridhjetë) ditë pune përpara fillimit të periudhës së mbajtjes.”.

2. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Mbikëqyrjes, si dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e ndryshimeve të rregullores “Mbi minimumin e rezervës së detyruar të mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”, të miratuara me këtë vendim në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.33, datë 11.5.2011

PËR NJË SHITESË NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË SË BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.14, datë 11.3.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, pas paragrafit të parë të nenit 3, të shtohet paragrafi me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“Përveç veprimtarive të parashikuara në nenin 54 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, bankat dhe degët e bankave të huaja lejohen të kryejnë veprimtarinë e shërbimit të kasave të sigurimit, pas licencimit ose dhënies së miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarisë shtesë nga Banka e Shqipërisë, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Ibrahimi

URDHËR
Nr.3652, datë 29.4.2011

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË NJË VEPRIMTARIE FINANCIARE NË LICENCËN E
SUBJEKTIT FINANCIAR JOBANKË AK-INVEST SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53 pika 4 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 126 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 6 dhe shtojcës 3 të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin nr.36 datë 26.5.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; të neneve 16 pika 1 shkronja “a” dhe 18 të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr.11, datë 25.2.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, pasi u njoha me kërkesën e subjektit financiar jobankë AK-INVEST sh.a., datë 19.11.2010, si dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes,

URDHËROJ:

1. Dhënie e miratimit për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë “Të gjitha format e kredidhënies” subjektit financiar jobankë AK-INVEST sh.a., licencuar nga Banka e Shqipërisë me licencën nr.07, datë 3.12.2003.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për komunikimin e këtij urdhri subjektit financiar jobankë AK-INVEST sh.a. dhe ndjekjen e zbatimit të tij.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij urdhri në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendësguvernator i Parë
FATOS IBRAHIMI

VENDIM
Nr.142, datë 29.4.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV A1”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV A1”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.143, datë 29.4.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV LEZHA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV Lezha”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
 2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.144, datë 29.4.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO E PARË MAT”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio e Parë Mat”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
 2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 15.1.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.145, datë 29.4.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV 6+1”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV 6+1”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
 2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 9.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.45, datë 10.5.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK ME SERI PV05V,
NR.29, LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.116,
DATË 28.12.2010

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pika 3 dhe neneve 12 dhe 15 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.5.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për modifikimin e licencës nr.29, seria PV05P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 28.12.2010, si dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

KONSTATOI SE:

Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a” (informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës), është dhënë në mënyrë të detajuar.
- Neni 15, pika 4, germa “b” (vendim me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës) është dhënë konform rregullores.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për modifikimin e licencës nr.29, seria PV05P, të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC Vithkuq.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Entela Shehaj

KËRKESË

Nr.1389/3, datë 6.5.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private (objekte dhe pemë dekorative), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rruga Paralele Tiranë-Vorë (krahu i majtë).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 30 618 537 (tridhjetë milionë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS PARALELE
TIRANË-VORË (KRAHU I MAJTË)

Nr.	Pronari			Z.K.	Nr.pas.	Lloji i pasurisë (objektit)	Vlera lekë	Shënime
1	Aleksandër	Spiro	Doci	2119	168/7	Karburant	7933676	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Aleksandër	Asllan	Shehu	2726	137/29	Karburant	9038199	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Beqir	Sinan	Mustafa	3974	166/89	Karburant	8296102	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Shefqet	Xhemal	Lamaj	2105	1180/38	Bar-restorant	4507460	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		Totali					29775437	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS PARALELE TIRANË-VORË
(KRAHU I MAJTË)

Lloji i pasurisë që shpronësohet: Dru dekorativë

Nr.	Pronari			Z.K.	Nr.pas.	Dru dekorativë vlera lekë	Shënime
1	Aleksandër	Spiro	Doci	2119	168/7	74200	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Aleksandër	Asllan	Shehu	2726	137/29	352800	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Beqir	Sinan	Mustafa	3974	166/89	344600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Shefqet	Xhemal	Lamaj	2105	1180/38	71500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		Totali				843100	

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr.3/22, datë 4.4.2011, vendosi heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Sami Çela, i datëlindjes 31.3.1962 dhe caktimin si kujdestar ligjor të tij kërkuesin, shtetasin Fatos Çela, i datëlindjes 25.2.1966.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr.1/14, datë 4.4.2011, vendosi heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Gëzim Goci, i datëlindjes 31.3.1992 dhe caktimin si kujdestar ligjor të tij babanë e tij, shtetasin Zenel Goci, i datëlindjes 7.7.1957.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr.5/27, datë 4.4.2011, vendosi heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasve Blerim Zylfa dhe Kastriot Zylfa, përkatësisht të datëlindjeve 2.12.1984 dhe 10.6.1982 dhe caktimin si kujdestare ligjore, motrën e tyre, kërkuesen Mirjeta Zylfa, të datëlindjes 18.8.1989.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr.359, datë 13.4.2011, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasve: Geg Matrizi, i biri i Kolës dhe i Barbulles, i datëlindjes 2.8.1954, lindur dhe banues në fshatin Gjashe, komuna Kolsh të rrethit Lezhë; Vitore Deda, e bija e Pashkos dhe e Mrikës, e datëlindjes 12.4.1956, lindur në fshatin Zejmen dhe banuese në fshatin Gjashe të rrethit të Lezhës; Flora Matrizi, e bija e Gegës dhe e Vitores, e datëlindjes 30.8.1977 lindur në Lezhë dhe banuese në fshatin Gjashe të rrethit Lezhë.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2804, datë 12.4.2011, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Arben Allko dhe caktimin e kërkueses, Adelina Allko, si kujdestare të pasurisë së tij.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 26.5.2011
Doli nga shtypi më 28.5.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 32 lekë